



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:030410
Datë: 08.08.2023
Numri i dokumentit: 04566910

C-IV.-14-0554

Ankuesi:

M G K.Klinë.

Kundër

Pala kundërshtare:

N.SH “Mirusha”, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit,
lagja Lakrishtë rruga “Dritan Hoxha” nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me dt. 08 gusht 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr.PEJ068-0195 i dt. 26 dhjetor 2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 29 janar 2014, ankuesi parashtror ankesë - kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr.PEJ068-0195 i dt. 26 dhjetor 2013, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensim për kontributeve pensionale në shumë prej 430 € nga N.SH “Mirusha” (në likuidim). Ankuesi pohoi se kërkesën e paraqet për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Ka shtuar se vendimi kontestues është i pa bazë dhe i pa pranueshmen dhe se baza juridike dhe ligjore e paraqitjes së kërkesës qëndron në dispozitat ligjore të Ligjit për AKP-në dhe Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës. Konsideron se kërkesa është e vlefshme sepse është paraqitur në

mënyrë të rregullte, është e afatshme, e ka bazën ligjore, është paraqitur nga pala me legjitimitet aktiv. Ka shtuar se është shkelur parimi Lex Specialis derogat Lex Generali, pasi që AL është thirrur vetëm në Ligjin për AKP-në kur dihet se këtë çështje e rregullon Ligji për Fondet Pensionale. Bashkë me ankesën ankuesi i ka bashkëngjitur: Kopjen e vendimit të atakuar, Kopjen e padisë drejtuar Gjykatës Komonale në Klinë, Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Një listë të pagave.

Me 22 shkurt 2016, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se palës i mungon legjitimitetit aktiv për të parashtruar kërkesën, ashtu që kontributet pensionale paguhen në llogarinë bankare të Fondit Pensional të Kosovës dhe jo në llogarinë bankare të parashtruesit. Ka shtuar se e kundërshton në tërësi si ekzistencën ashtu edhe lartësinë e pretendimeve të parashtruesit. Ka shtuar se sipas par.2a dhe 2b të nenit 6 të Ligjit nr.04/L-101 punëdhënësi do të paguaj në shumë të barabartë me 5% të rrogave të përgjithshme të gjithë punonjësve të saj, dhe çdo punonjës paguan një shumë të barabartë prej 5% të pagave në total të saj. Sipas par.3 të këtij neni, punëdhënësi zbret kontributin e punonjësit nga rroga dhe e bartë në llogarinë e posaçme të Fondit së bashku me kontributin e punëdhënësit. I ka kërkuar gjykatës që të refuzoj ankesën dhe të vërtetoj vendimin e AL.

Përmes parashtresës së dt.21 mars 2016 ankuesi paraqiti përgjigjen e tij ndaj mbrojtjes së të paditurës, ku ndër të tjera ka theksuar se baza ligjore sipas të cilës AL e ka refuzuar kërkesën e tij nuk qëndron dhe është në kundërshtim me Ligjin për Fondet Pensionale dhe se AL nuk ka bërë vlerësim të saktë të provave. Si provë ka bashkëngjitur Listën mbi llogaritjen dhe pagesën e të ardhurave personale dhe ndalesat e bëra në emër të kontributeve pensionale të zbitura nga paga e muajit gusht 2003.

Me dt.23 maj 2016, e paditura ka paraqitur në gjykatë kundërpërgjigjen e saj, ku ka pohuar se parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur asnjë dëshmi që të mbështeste pretendimin dhe as ka arritur të kundërshtoj ndonjë prej argumenteve juridike të llastuara në vendimin e AL.

Arsyetimi ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se “*pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtruesat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)*”, ndërsa pika 3 parasheh se “*pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë*”.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtorë e NSH-së, por kontestues ka qenë fakti nëse NSH i ka mbetur borxh kontribute pensionale të pa paguara në shumën e kërkuar nga ankuesi.

Gjykata nga shkresat e lëndës vjen në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH “Mirusha” nuk i ka bërë pagesën e kontributit pensional gjatë periudhës së kërkuar. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij.

Kopja e vendimit të atakuar të Autoritetit të Likuidimit, Kopja e padisë drejtuar Gjykatës Komunale në Klinë, Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i cili nuk përmban emrin e ankuesit, Lista mbi llogaritjen dhe pagesën e të ardhurave personale dhe ndalesat e bëra në emër të kontributeve pensionale të zbritura nga paga e muajit gusht 2003 e cila nuk përmban logon e as vulën e NSH-së si dhe nuk është e nënshkruar nga askush, nuk dëshmon se N.SH nuk i ka paguar ankuesit kontributet pensionale. E paditura as në vendimin e saj e as përmes mbrojtjes nuk e mohon që ta ketë kryer detyrimin kontributit pensional, por kategorikisht thirret në çështjen e të provuarit para gjykatës dhe në arsyetimin e bazuar se pagesa e kontributeve nuk i bëhet parashtruesit në llogarinë bankare por në trustin pensional të Kosovës. Deri sa e paditura ka paraqitur një mbrojtje të tillë ishte obligim i ankuesit të sjell dëshmi për mos pagesën e kontributeve të tilla.

Ankuesi përmes përgjigjes në mbrojtjen e AKP pati mundësi që të parashtronte prova në mbështetje të pretendimeve të tija ankimore, ashtu sikurse i ka bashkangjitur Listën mbi llogaritjen dhe pagesën e të ardhurave personale dhe ndalesat e bëra në emër të kontributeve pensionale të zbitura nga paga e muajit gusht 2003, por as edhe kjo provë nuk dëshmoj se ankuesit N.SH i ka mbetur ndonjë borxh të pretenduar. Ankuesi nuk bëri dorëzimin e asnjë prove e cila do të shkonte në favorin e tij, dhe se barra e të provuarit bie mbi të si pretendues i një të drejte ligjore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi është e liruar nga pagimi i taksës gjyqësore meqë vlera e kontestit është nën shumën prej 1000 €.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

G j y q t a r i

Shkelzen Sylaj